



## REPUBLIKA E KOSOVËS

### KOMUNA VUSHTRRI



---

#### Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Më 21. 09. 2017

## KONKURS LETRAR

### Për poezi

Për të 35-tën herë me radhë, në Vushtri do të mbahet Festivali i Poezisë “**Takimet e Poeteshave Shqiptare**”.

Inkurajojmë të gjitha krijueset nga të gjitha trojet shqiptare por edhe nga diaspora që me poezitë e tyre të konkurrojnë në këtë Festival të poezisë.

Konkursi është i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes (deri më **05 tetor 2017**).

Poetet që konkurrojnë duhet të dërgojnë një poezi me emër dhe mbiemër, patjetër duhet të dërgohen dy numra kontakti si dhe një biografi e shkurtër për krijimtari letrare bashkë me një foto portret.

Pas përzgjedhjes së poezive nga juria profesionale, do të kontaktohen vetëm poetet, poezitë e të cilave janë përzgjedhur për konkurrim. Ato do të njoftohen përmes telefonit më së largu deri më **10 tetor 2017**.

Në këtë manifestim dy ditë të poezisë do të ndahen tri çmime kryesore për poezi:

**Çmimi i parë 500 €**

**Çmimi i dytë 300 €**

**Çmimi i tretë 200 €**

Si dhe çmimi “Debutuesja” me vlerën prej **100 €**, i cili i ndahet poeteshës më të re në moshë që merr pjesë për herë të parë në këtë festival.

Për të gjitha poetet poezitë e të cilave do të përzgjidhen nga juria për pjesëmarrje në manifestim, organizatori mbulon shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit.

Poezitë dërgohen në këtë adresë:

**tpsh@outlook.com**

Për informata më të hollësishme mund të shkruani në e-mail adresën më lartë si dhe të shikoni web faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë: <http://kk.rks-gov.net/vushtri>.